

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI⁴², mbledhja e 12) me dt.30.11.2020 (e hënë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Rishikimi i Planit të Veprimit për Rekomandimet e ZKA-së dhe Lista e rreziqeve
4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për formimin e Ndërmarrjes publike lokale "Kastrioti"
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29/30.10.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena, (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Fatmir Bektoshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, drejtorët komunal, Rifadije Paloja, udhëheqëse e sektorit për kulturë, përf.e KFOR-it, përf.e Qendrës rinore dhe përf. i IZHL-së
Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Statutit të Ansambllit të këngëve dhe valleve Obiliq
4. Shqyrtimi i Raportit financiar janar-shtator 2020
5. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së për transfer dhe rialokim të mjeteve
6. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e lëndës C.nr.847/08 e dt.16.11.2011
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesi – Sot në rrethana tjera, po e hapim mbledhjen dhe ju njoftoj se anëtari i Kuvendit komunal, kolegu ynë Muhamet Mustafa.ka vdekë.

Kryesuesi me rastin e vdekjes së anëtarit të Kuvendit komunal, i ftoi të pranishmit për një minutë heshtje, në shenjë nderimi.

Pas nderimit me një minut heshtje mbledhja u ndërpre për të vazhduar të nesërmen me dt.30.10.2020.

Kryesuesi – Ju e dini se me dt.29, e kemi filluar mbledhjen e Kuvendit me ç’rast mbajtëm 1’ minut heshtje me rastin e vdekjes së kolegut tonë Muhamet Mustafa dhe tash po e vazhdojmë mbledhjen.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës i cili u aprovua njëzërit nga të gjithë.

Pika e parë e rendit të ditës

Të pranishëm janë 20 anëtarë të Kuvendit komunal.

Pika e 2 e rendit të ditës

Fatos Kurshumlija – Paraqet vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, te shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK Llazarevë, sepse nuk janë të shenuar te diskutimi im fjalët “Nuk mund të votoj kundër”.

Aziz Bici – Paraqet vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar sepse në pikën e dytë të rendit të ditës në vend të fjalës “hekurudha” duhet të jetë “autoudha, apo autostrada”.

Miratohet unanimisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjet e cekura më lartë..

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për sqarim më të gjerë rreth Draft Statutit të Ansamblit të këngëve dhe valleve Obiliq, fjalën ia dha znj.Rifadije Paloja, udhëheqëse e sektorit për kulturë.

Rifadije Paloja – Ne si Komunë e vogël që jemi, por edhe potencialet krijuese si dhe ato shfrytëzuese të të mirave kulturore pretendojmë të arrijmë nivele më të larta. Prandaj DKRS/ja, për të krijuar një rreth veprimtarish sa më tërheqëse konsiston në atë që të inkuadrohen sa më shumë individë, grupe dhe komunitete pakicë, qoftë si krijues dhe grupe si përfitues të të mirave në fushën e kulturës. Po ashtu, duke pasur parasysh që tashmë është krijuar një infrastrukturë e përshtatshme për zhvillimin e veprimatrive kulturore siç është Shtëpia e kulturës, konsideron se themelimi i Ansamblit dhe hartimi i këtij dokumenti është shumë i nevojshëm.

Lulzim Sadiku – Unë them që ky Draft Statut i Ansamblit të këngëve dhe valleve duhet të delë në diskutim publik dhe në fund këto dokumente duhet të përfshihen në buxhet. Mendoj se të gjitha këto e kanë një kosto dhe për këtë arsye ne duhet ta kemi një pasqyrë në mënyrë që të dijmë kur e kemi rishikimin e buxhetit.

Nora Preniqi – Sigurisht se si LB, do ta përkrahim këtë Draft Statut, por pyes se a është ky Draft Statut vetëm për komunitetin shqiptarë, apo mund të jetë edhe për komunitetet tjera.

Kryesuesi – Përgjegjet po është për të gjithë dhe janë të mirëseardhura të gjitha komunitetet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në diskutim publik të Draft Statutit të Ansamblit të këngëve dhe valleve në Obiliq.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për një sqarim më të gjerë rreth raportit financiar janar shtator 2020, fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli – Sa i përket raportit 9 muajor realizimi i të hyrave vetanake është 651.140.03 €, që do të thotë 63.7 është rritë përqindja e realizimit të të hyrave vetanake. Pastaj, i kemi paga dhe medijtje, buxheti i alokuar për 9 muaj është 3 milion e 131,706.05 €, të hyrat e bartura janë 78,000 €, që në total janë 3 milion e 209,706.06€, ndërsa shpenzimi është 3,130,221.05 €. Te mallrat dhe shërbimet të gjitha Drejtoritë komunale buxhetin kanë edhe të hyrat e bartura që është 684,584.81 €,ndërsa shpenzimi është 364,343.22 €. Te shpenzimet komunale, buxheti është 259,371.83 €, ndërsa shpenzimi është 132,062.69 €. Subvencione dhe transfere, buxheti i alokuar është 594,976.95 €, ndërsa shpenzim janë 302,520.03 €.Te subvencionet, ne kemi pasur sfida sepse krejtë prej të hyrave vetanake kemi arritë me i plotësue vijat buxhetore. Te shpenzimet kapitale, total buxheti është 5 milion e 399,147.19€, ndërsa shpenzimi është 1 milion e 632,947.95 €.Ju e dini se ka pasë probleme edhe me procedurat e shpalljes të Prokurimit publik, por shpresoj se deri në fund të vitit të realizohen dikund rreth 90 %.

Lulzim Sadiku – Unë e dëgjova drejtoreshën se do të shpenzohet buxheti 90 %, që mendoj se mbetet shumë e madhe sepse ne kemi buxhet 12 milion, e 10 % dhe nëse na mbetet 10 %, i bjen 1 milion e 200,000 €, me na teprue që janë shumë dhe kisha thënë me i shpenzue këto mjete. Diçka që më brengosë është fakti te shpenzimet kapitale 30 %. Vërtetë po frigohem sepse jemi në muajin e 10, pothuajse në fillim të muajit 11, dhe të mbetet shuma 30 % e shpenzimeve, por unë e kuptoj se në fund mund të kryhen projektet. Mirëpo, sikur kjo shumë të ishte 50, ose 60 %, ndoshta isha pajtuar se jemi afër, ose jemi mirë. Kjo, vërtetë më shqetëson sepse prapë po shkojmë te mbetja e suficitit në vitin 2020. Ne e kemi pasë këtë problem edhe në vitin 2019, sepse Komunës tonë i kanë mbetë fitim mbi 1 milion €, mund të them afër 2 milion. Unë kërkoj që në mënyrë miqësore këtë fakt me shikue ndryshe edhe pse jemi në situatën përfundimtare të vitit, këto shpenzime të kryhen te shpenzimet kapitale. Te të hyrat vetanake, e kuptoj se jemi në pandemi, ka të mbledhura shumë pak të hyra dhe po duket se është një shumë mjaft e vogël, që për shkak të buxhetit që e

kemi është punuar shumë pak në këtë drejtim, të mos them se nuk është punuar fare. Është çështja e suficitit, që vërtetë po na mbetet tash neve, të mos merremi me të hyrat vetanake, që mund ti lazdroyjmë edhe operatorët, firmat për punët që kryhen brenda Komunës së Obiliqit. Ne nuk e votojmë, por te informatat dhe te shpenzimet duhet të jemi të saktë.

Fatos Kurshumlja – Dua të pyes te gjobat dhe denimet janë 6,366 €, këto shpenzime kanë hyrë edhe pse ne nuk po e dijme se çka kemi paguar gjoba si Komunë.

Zarife Behluli – Përgjegjet se z.Lulzim Sadiku e ngriti një çështje, që e ka brengë shpenzimin e buxhetit, që e kemi të gjithë. Mirëpo, unë e cekta se në periudhën janar-shtator përqindja vërtetë është e vogël dhe sot kur raportova është 50 %, shpenzimi i investimeve kapitale. Edhe një muaj e gjysmë po e llogariti dhe unë thashë të shpresojmë të arrijmë deri në 70 %, ndërsa pjesën që e kemi me mjete, me të hyra vetanake ato nuk janë të rrezikuara sepse rrezikim janë pjesa e mjeteve nga Qeveria. Të hyrat nga gjobat janë denimet në trafik, denimet e Drejtorisë së inspeksionit, mjedisit pavarësisht se cila Drejtori shqipton gjoba dhe ato janë të parapara që alokimi i tyre të bëhet në investime kapitale. Mirëpo, në këtë vit, ne i kemi pasë vetëm 30,000 €, te një projekt asfaltimi i rrugëve, pastaj e kemi të drejtën me i mbushë kategoritë tjera ekonomike.

Nazmi Gashi – Pyeti lidhur me denimet që shqiptohen për maskat, a hyjnë te ne.

Kryesuesi – Përgjegjet jo, sepse është ligji i veçantë për këtë çështje. Ne nuk duhet të harrojmë një gjë, se viti 2020 është viti i sfidave, i mbijetesës i institucioneve komunale dhe kjo pandemi nuk e ka përfshi vetëm Obiliqin, por krejtë regjionin. Uroj që banorët e Komunës së Obiliqit, ta kalojnë sa më lehtë, të kemi sa më pak raste dhe viktima të kësaj pandemie.

Pika e 5 e rendit të ditës

Zarife Behluli – Sa i përket transferit dhe rialokimit të mjeteve, nga Drejtoria e shëndetësisë projekti (kodi 46804) “Renovimi i objekteve në QKMF AMF dhe QMF” transferohen mjetet në vlerën prej 12,987.84 €, kalojnë në projektin Blerja e veturave” (kodi 49743). Në DSHPE, projekti (kodi 45577) “Ndërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të qytetit” rialokohet vlera prej 4,665.82 €, kalon në projektin “Blerja e veturave” (kodi 49743). Në DSHPE, projekti (kodi 48615) “Rregullimi i varrezave dhe mirëmbajtja” rialokohet vlera 1,620.12 €, në projektin “Blerja e veturave” (kodi 49743). Transfer janë 12,987.84 €, ndërsa rialokim janë 6,267.94 €.

Totali i transferit dhe rialokimit është 19,255.78 €.

Kryesuesi – Edhe në mbledhjen e KPF-së, është shqyrtuar kjo çështje dhe ju e dini se nuk kemi mundësi me hapë kode të reja në kategoritë e caktuara.

Lulzim Sadiku – Në vijën buxhetore nga Drejtoria e shëndetësisë kemi kërkuar dhe kemi ndarë një shumë prej 20,000 €, për blerjen e një makinë të re për punët për vitin 2021. Unë sa e di në buxhetin e vitit 2021, kemi ndarë 70,000 €, për blerjen e makinave dhe prapë të bëjmë rialokim të mjeteve, më duket se është shumë lluks. Pra, kemi paraparë që brenda një viti, 90,000 €, të blejmë vetura sepse kjo nuk është diçka e arsyetuar dhe nuk është e analizuar. Ne jemi në një situatë që kemi buxhet, falë Ligjit për Obiliqin, por nëse për vitin kalendarik brenda një viti 90,000 €, janë paraparë për vetura. kjo është lluks. Nëse, këto mjete shkojnë në një vijë ku mund ti gjejmë njëqind arsye që ti realizojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, unë do të isha për. Mirëpo, 90,000 €, të blehen vetura më duket se është pak në shpejtësi dhe e paarsyetuar mirë. Prandaj, unë si grup do të jem kundër.

Fatos Kurshumlja – Te rialokimi i mjeteve, te rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave, rialokohen 1,620 €, por unë nuk e di se janë rregullue dhe mirëmbajtë të gjitha varrezat. Pyes, pse mos të vazhdoj ky projekt që të mirëmbahen të gjitha varrezat.

Aziz Bici – Sa i përket kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për financa për rialokimin e mjeteve, mendoj se nuk duhet të votohet sepse po kërkohen mjete nga Drejtoria e shëndetësisë. Mendoj se ka ku të harxhohen këto mjete sepse ne ende vazhdojmë të jemi me pandemi, e sidomos tani kur vazhdon të jetë infeksioni në rritje. Unë jam i sigurtë se kabina dezinfektuese në qytetin tonë është jashtë funksionit dhe është ashtu qysh ka qenë dhe me i marrë këto mjete, me i dërgue në blerjen e veturave, mendoj se nuk

qëndron. Po ashtu, për rregullimin e stacioneve pothuajse, të gjitha stacionet ose janë xhamat e thyer, ose janë karrigat e dëmtuara. Mendoj se për këto stacione është dashur të mendohet të mirëmbahen dhe mos të mbeten në gjendjen çfare kanë qenë. Po ashtu, edhe për varreza kudo që të shkojmë varrezat nuk janë në gjendjen jo më të mirë, por janë në gjendje të mjerueshme. Prandaj, me i marrë këto mjete dhe me ble vetura, mendoj se është dashur të gjithë sot mos ta votojmë rialokimin e mjeteve.

Nazmi Gashi – Mendoj se këto mjete duhet me ia dhënë Kuvendit, që ne me i rregullue kushtet tona.

Ibush Mjekiqi – Çështja e rialokimit të mjeteve është ajo që drejtoresha i përmendi 3 projektet, të cilat janë të kontraktuara dhe të përfunduara. Këto, janë mbetje të projekteve. Drejtorja e shëndetësisë nuk ka kërkuar me ble veturë, por është kërkuar nga Drejtorja e shëndetësisë, që të merren mjetet prej projektit të renovimit që është kryer sepse kanë qenë të parapara 35,000 €, por ka ardhë kompania me 22,000 €, dhe kanë mbetë mjete. Këto, mjete nuk mund të shpenzohen dikund tjetër, vetëm në projekt kapital. Ky Kuvend i ka ndarë në vitin e kaluar 105,000 €, për blerjen e veturave dhe me këto mjete janë kontraktuar 6 vetura, por na është ofruar edhe një që mund ta blejmë nëse, këto mjete i marrim dhe i shpenzojmë. Nëse, ju sot nuk e votoni rialokimin e mjeteve, atëherë ato mjete shkojnë në suficit. Kontrata për mirëmbajtjen e varrezave është lidhë në shumën e caktuar, që nuk e di tash sa dhe është lidhë kontrata 40,000 €, tash kanë mbetë 1,100 €, prej asaj kontrate dhe këto duhet të barten këndej. Pra, me kontratë për renovim të varrezave kryhet ajo çka është planifikue, ndërsa mbetja bartet për blerjen e veturës. Prandaj, unë ju lus që të votoni në mënyrë që këto mjete të mos shkojnë në suficit.

Kryesuesi – Është mirë të mendoj Ekzekutivi, që në të ardhmen e afërt që me qenë Komuna e parë, ndoshta për me fillue me vetura elektrike sepse shpenzimet nuk janë të mëdha dhe mirëmbajtja është më e lehtë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 6 vota kundër e aprovuan Vendimin për transfer dhe rialokim të mjeteve për vitin 2020.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DSHPE-së për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e lëndës C.nr.847/08 e dt.16.11.2011.

Naim Miftari – Këtu, bëhet fjalë për aktgjykimin i cili thotë se Kuvendi komunal, udhëzohet të bëjë emërimin e Komisionit të ri në të cilin Komision nuk duhet të jenë të përfshirë anëtarët e ndarjes së banesave me qira për 10 vite, duke u bazuar në Statutin e Komunës. Neni 6 dhe 7 i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit është i detyrueshëm për eliminimin e thirrjeve dhe vlerësimeve individuale Kërkojmë nga Kuvendi që të caktoj 2 anëtarë për formimin e këtij Komisioni.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që të formohet Komisioni.

Lulzim Sadiku – Në materialin e fundit që e kemi marrë është shkresa e Gjykatës, ka ardhë vetëm një vendim që të formohet ky Komision. Pastaj, unë i kam marrë edhe 3,4 vendime se kjo lëndë është në Gjykatë, do të thotë se lënda ende është e papërfunduar. Ne kemi pasë një rast dhe iu kemi thënë 16 mësimdhënësve tërhiqni lëndët nga Gjykata se ne marrim vendim. Fatkeqësisht, ne jemi ata që nuk guxojmë të marrim vendim sepse ua kemi humbë të drejtën mësimdhënësve nga se, ua kemi heqë mësimdhënësve lëndët nga Gjykata, se do të ua paguajmë, por nuk kemi marrë asnjë vendim. Mendoj se nuk duhet të veprojmë padrejtë ndaj qytetarëve. Kjo lëndë është në Gjykatë dhe le të vazhdoj në Gjykatë, ashtu qysh ka veprue më heret, por të marrim vendim mbi vendim derisa lënda është në Gjykatë, nuk mendoj se kemi të drejtë. Unë dua të them që mos ta përsëritim gabimin që kemi vepruar para një viti sepse ne mësimdhënësit i kemi mashtruar dhe nuk i kemi rregulluar gjërat ashtu, qysh kemi thënë. Prandaj, kërkoj që mos të marrim asnjë vendim derisa lënda është në Gjykatë, sepse është e padrejtë.

Ibush Mjekiqi – Nëse, ky Kuvend ka marrë vendim me i thënë dikujt tërhiqje lëndën nga Gjykata, kisha dashur të ceket kur sepse ky Kuvend nuk e di që ka marrë vendim, për me i tërheqë lëndët nga Gjykata.

Lulzim Sadiku – Në kohën e ish kryesuesit të Kuvendit, të ndjerit Adem Preniqit, ne e kemi marrë një vendim që me ua bë pagesën mësimdhënësve të vitit 2013 dhe 2014. Aty, e kemi cekë se ata të cilët i kanë lëndët në Gjykatë, ti tërheqin sepse ne ua bëjmë pagesën. Të gjithë mësimdhënësit në atë kohë i kanë tërheqë lëndët nga Gjykata, ua kanë kërkuar edhe xhirollogaritë, që të iu bëhet pagesa dhe ata kanë mbetë në

Millosevë dhe Raskovë. Ky është realitet sepse nuk them gjëra që nuk janë dhe këto gjëra kanë ndodhë, prandaj kërkoj mos të ndodhin më.

Linda Sadiku – Unë sa e pashë materialin, mendoj se nuk është dërguar komplet, ashtu qysh e kam dorëzuar në mbledhjen e KPF-së. Këtu, është vetëm vendimi i shkallës së parë ndërsa, unë kam material më shumë për ju kolegë, anëtarë të Kuvendit, që të jeni të mirë informuar, gjithashtu edhe për anëtarë të Komisionit që do të zgjidhen, që të kenë një pasqyrë reale rreth kësaj gjendjeje. Pjesa tjetër që dua të diskutoj është se nga këta 3 emra të propozuar, ku në mesin e tyre nuk e pashë emrin e drejtorit të DSHPE-së, i cili në mbledhjen e kaluar të KPF-së, u zotua se në rast se është duke vepruar kundërligjshëm të gjitha përgjegjësitë do ti marrë vetë. Tani, shtrohet pyetja si do ti marrë përgjegjësitë duke mos qenë pjesë e Komisionit, prandaj kërkoj që emri i drejtorit të zëvendësohet me ndonjërin nga këta 3 anëtarë, sepse të gjithë e dijmë se përgjegjësia bie mbi anëtarë të Komisionit. Ne e dijmë se kjo lëndë është e trashëguar me vite, por askund nuk është cekë se Komuna ka marrë një gjobë në vlerën prej 5,000 €, dhe do të marrë gjoba të vazhdueshme deri në marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit. Pastaj, vendimi i Gjykatës, i vërtetuar edhe nga Gjykata e apelit, thotë qartë të bëhet rindarja e banesave, jo e banesës sepse në anën tjetër në momentin e hapjes së konkursit për rindarje do të njoftohet Zyra përmbarimore me kontrollue se a janë kushtet për rindarje nga se vendimi thotë qartë se ato duhet të boshatisen. Ndërkaq, ne po krijojmë probleme tjera, me familjet tjera, kur e dijmë se ka përfitues që tani më janë pensionuar dhe çdo lakim i këtij vendimi të Gjykatës, është përgjegjësi penale për anëtarët e Komisionit. Unë kam një lutje për të gjithë anëtarët e Komisionit, që ti kërkojnë të gjitha vendimet e Gjykatës, sepse ne nuk jemi mbi Gjykatën, ta shikojnë mirë lëndën dhe të mos shikojnë në përgjegjësi penale, as për kreditorin, as për debitorin sepse nuk ia vlen.

Aziz Bici – Mendoj se kërkesa për formimin e këtij Komisioni, nuk i plotëson kushtet ligjore për arsye se neve, na kanë ardhë nga dikah tjetër edhe 2 informacione nga Gjykata themelore dhe një urdhrë përmbarimor. Në rast se i referohemi kësaj, ky Komision nuk mund ta kryej punën e vet. Çfarëdo që është ligjore unë e përkrahu, por mendoj se pasi nuk është brenda procedurave, atëherë ne duhet të ia lejmë Gjykatës sepse sa e kam parë unë nuk e ka formën e prerë të Gjykatës. Prandaj, mos ti ngatërrojmë gjërat, ti lejmë hapësirë Drejtorive, dhe palës e cila ka ushtruar ankesë për me fitue të drejtën e vet.

Armend Rushiti – Edhe unë jam kundër kësaj.

Nazmi Gashi – Unë kam thënë se nuk jam mirë i informuar.

Shaip Paloja – Ne këtë pikë të rendit të ditës, ju e dini se e kemi pasë edhe në seancën e kaluar, por në mungesë të vendimit të Gjykatës, këtë lëndë nuk e kemi trajtuar. Tash, materiali që neve na ka ardhë është një vendim i Gjykatës, së paku një pjesë e vendimeve sa kam mund unë me lexue, është vërtetuar se janë bërë disa shkelje në ndarjen e këtyre banesave, së paku 3 që i ka konstatue edhe Gjykata. Mirëpo, njëkohësisht Gjykata, kërkon edhe formimin e Komisionit për verifikim të këtyre banesave. Tash, unë nuk e kam të qartë Komisioni i cili formohet a do ti marrë parasysht të gjitha banesat që janë aty, apo do të merret vetëm me lëndën konkrete. Pra, kërkoj sqarim nga drejtori për këtë çështje. Uroj që Komisioni ta kryen punën dhe të nxjerrë një rezultat përfundimtar në mënyrë që të mos dëmtohet askush.

Naim Miftari – Përgjegjet se aktgjykimin të cilin ne e kemi nëse, e keni shikuar mirë është i plotëfuqishëm dhe një çështje që është e gjykuar nuk mund të kthehet në rigjykim. Unë e kuptoj kërkesën e anëtarit të Kuvendit, që kjo çështje të prolongohet, bile kishte me qenë mirë që anëtarja e Kuvendit, për shkak të konfliktit të interesit mos të marrë pjesë në votim.

Linda Sadiku – Nuk është konflikt interesi sepse kur ka ndodhë kjo çështje e proceduar nga viti 2002, unë as që e kam njoftë këtë familje.

Lulzim Sadiku – Pyeti se lënda a është duke vazhduar në Gjykatë dhe i kemi edhe 4 vendime tjera, ndërsa ju na e keni dërguar vetëm një vendim.

Naim Miftari – Unë nuk dua të paragjykoj se Komisioni do të punoj kështu, apo ashtu sepse Komisioni do të punoj konform aktgjykimin të Gjykatës.

Aziz Bici – Ju po flisni për vendimin e vitit 2011, që është i plotëfuqishëm, por ne e kemi edhe për vitin 2014.

Naim Miftari - Sqaron se fjala është për vendimin nr.I-96, të vitit 2014, formohet Komisioni i cili e shqyrton lëndën dhe bjen një përfundim. Po ashtu, Komisioni me një procesverbal me shkrim do ta njoftoj Kuvendin komunal për punën e kryer.

Fatos Kurshumlja – Drejtor, më heret pyeti edhe z.Shaip Paloja, se ky Komision a do të merret edhe me këto 3 çështjet tjera, apo vetëm me lëndën konkrete.

Naim Miftari – Përgjegjet konform objektivave, sipas aktgjykimit.

Kryesuesi – Vendimet që janë marrë në vitet e mëhershme po na trashëgohen dhe po na përcjellen, që do të thotë se edhe vendimet tona kanë me përcjellë dikend. Mirëpo, ne duhet ta zgjidhim çështjen e asaj banese dhe e di se Komisioni i formuar nga ky Kuvend, do të na sjellë një raport. Ne duhet ta mbrojmë interesin e Komunës sepse për këtë arsye qyetarët na kanë sjellë këtu, prandaj duhet ti zgjidhim edhe çështjet e trashëguara.

Aziz Bici – Këtu, nuk ka të bëjë me interes të Komunës, por ka të bëjë me interesin e atyre që kanë bërë keq.

Nazmi Gashi – Mendoj se Komisioni i cili do të formohet nga Kuvendi, do ta ketë qëllimin e mirë, pozitiv dhe ti kryej detyrat e caktuara. Unë e di më së miri gjendjen e atij objekti sepse kur isha në detyren e kryeinspektorit në Komunë, e kam shqyrtue. Aty, nuk është me rëndësi qysh ka qenë ndarja e banesave sepse ndarja nuk është e kënaqshme asnjëherë, se edhe tash po të bëhet ndarja e banesave, do të ketë pakënaqësi. Është me rëndësi se ne a do të nxjerrim një epilog të drejtë lidhur me pronën, e cila është pronë komunale dhe Komuna, e ka për detyrë me nxjerrë një vendim të përbashkët dhe të drejtë. Mendoj se Komisioni, e ka për detyrë me nxjerrë një epilog pozitiv për Komunën sepse këtu, për këtë ne jemi. Unë nuk kam kurrfarë informate administrative sepse nuk më ka punuar kompjuteri që 2 muaj.

Aziz Bici – Së pari, për gjithë atë që folëm mendoj se askush nuk është kundër mbrojtjes së interesit të Komunës, sepse jemi të gjithë për me mbrojtë interesin e Komunës. Unë qysh e kam lexue lëndën nuk jam për me mbrojtë hiç, absolut rastin konkret, ai që e ka kërkuar këtë të drejtë, absolut nuk jam, as nuk kam simpati ndaj asaj partie politike, as kurgjë hiç. Mendoj se nëse, ai Komision voton diçka të padrejtë, le ta din se duhet ti bartë pasojat për veprimet e veta. Ne e dijmë se e kemi formue edhe një Komision për ndarjen e banesave të Hades, dhe e dijmë se edhe aty nganjëherë ka pasë konflikt interesi. Prandaj, unë jam për atë që mos u ngutni dhe prapë po i them drejtorit të shërbimeve publike, se neve, na e ke dërgue vetëm një material të vitit 2011, dhe material tjetër nuk kam. Neve, na ka ardhë edhe një material tjetër, jo nga administrata e Kuvendit komunal, jo prej teje si drejtor, por na ka ardhë prej dikah tjetër. Ne e kemi një urdhër përmbartimor të vitit 2014, që i ka 3 vite më shumë prej atij vendimi, që po thirret drejtori. Unë për këtë arsye po them se ne duhet ti respektojmë procedurat dhe të dijmë se çfarë vendimi po marrim. Kjo, drejtor është edhe në interesin tënd sepse mos harro se ti sikur të ishe pjesë e Komisionit, që e merrë përgjegjësinë, ma merr mendja se ishe kujtue se çka po bën. Ndërsa, ne do ti përcjellim edhe këto vendime se kush çka po vepron për këtë çështje.

Linda Sadiku – Drejtori tha se është konflikt interesi, por unë nuk mendoj se është konflikt interesi. Unë kërkoj edhe njëherë që drejtori të bëhet pjesë e këtij Komisioni, pasi që dëshiron ti marrë përgjegjësitë. Nuk, keni pasë të drejtë ligjore me bë privatizim, përderisa lënda është në proces gjyqësor. Për këtë iu ka njoftue dhe e keni dokumentin e protokoluuar në Komunë, në vitin 2014. Pastaj, kur është fjala te privatizimi, pse ka qëndrue lënda plot 6 muaj te noteri i Obiliqit dhe prapë nuk e kanë noterizuar me arsyetimin se lënda është në proces gjyqësor.

Kryesuesi – Unë e ftoj edhe opozitën që të jetë pjesë e Komisionit, në mënyrë që ta shohë krejtë lëndën, të ketë transparencë sa më shumë dhe të mos bëhen gabime.

Nazmi Gashi – Kryesues, këtu nuk është çështja se kush është duke i shfrytëzuar banesat, por këtu ka të bëjë me pronën. Ky është objekt projekt kapital dhe investimet kapitale dikund e kanë zanafillën. Prandaj, përfundimisht duhet me zgjidhë këtë çështje, pasi që është pronë e Komunës, duhet me gjetë arsyetimin.

Aziz Bici – Unë këtu, nuk jam duke folë si jurist sepse nuk jam jurist dhe unë këtu jam duke folë për vendimin të cilin do ta marrim të jetë brenda kornizave ligjore. Kjo çështje sikur të mos ishte neglizhues kishte me u krye shumë moti. Unë nuk jam i interesuar që mundem me dhënë kontribut për me qenë anëtar i këtij Komisioni, por unë jam asambleist që kam obligim me i respektue këtu, të drejtat e secilit qytetarë. Po ashtu, e kam obligim me përcjellë se a keni pasë qëllim vetëm me neglizhues formimin e këtij Komisioni, apo vërtetë keni qëllim me zgjidhë këtë çështje njëherë e përgjithmonë. Deri më tash, nuk na keni ofruar material të mjaftueshëm se ju vërtetë, doni me zgjidhë këtë çështje.

Kryesuesi – Unë atë material që ma kanë sjellë edhe ua kam dërguar juve. Ne i kemi 3 propozime nga Ekzekutivi, për përbërjen e Komisionit Hamit Mjeku, Vlora Halimi dhe Fitim Dedinca. Tash, duhet ti kemi edhe 2 propozime nga anëtarët e Kuvendit komunal.

Enver Gashi – Propozon z.Nazmi Gashi, për anëtar të Komisionit.

Labinot Mirena – Propozon z.Fatmir Bekteshi, për anëtar të Komisionit.

Aziz Bici – Unë e kam një propozim se duhet ti japim epilog dhe ju vetë duhet me konstatue, me ditë se ku është problemi, ju si Komision që në të ardhmen duhet të votoheni. Ndërsa për ne duhet ta dijmë se cili është vendimi juaj dhe nëse, nuk e keni këtë përgatitje çka mundemi ne me ndihmue në këtë çështje. Pra, ju së bashku me palën e cila kërkon të drejtën e vet dhe në momentin që ju na ofroni material, është shumë e lehtë sepse ne vetëm ju përkrahim dhe çështja kryhet. Unë vetëm çka kam lexue aty, personalisht dhe si përfaqësues i LVV-së, e kontestoj komplet punën e atij Komisioni se qysh i ka ndarë ato banesa.

Fatmir Bekteshi – Unë dua që në vendin tim të jetë dikush tjetër anëtar i Komisionit.

Kryesuesi – Këtë nuk kisha me thënë.

Lulzim Sadiku – Ne nuk jemi që dijmë shumë, por jemi ata të cilët kërkojmë që lënda të shkoj përmes Gjykatës sepse është e papërfunduar. Unë edhe më heret thashë se lënda është në Gjykatë dhe le të vazhdon mëtutje në Gjykatë, sepse janë 3,4 vendime dhe ne e kemi prolonguar para kësaj mbledhjeje me qëllim që me na ardhë materiali. Mirëpo, materiali komplet nuk ka ardhë dhe ne jemi për atë që lënda të mbetet në Gjykatë, derisa të përfundoj.

Nazmi Gashi – Këtu, u tha se noteri nuk e ka vërtetue dhe nuk është me rëndësi ndarja e banesave, nuk është me rëndësi kush e ka marrë banesën, por është me rëndësi vërtetimi i pronës. Mendoj se Komisioni duhet ta vërtetoj se ky objekt është pronë e Komunës. Unë as sot nuk jam i kënaqur me ndarje dhe sot po të bëhet ndarja kush e merrë banesën, nuk do të jem i kënaqur.

Kryesuesi – Propozon që të formohet Komisioni sipas kërkesës së Kryetarit për shqyrtimin e lëndës C.nr.847/08 e dt.16.11.2011.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan Vendimin për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e lëndës Cnr.847/08 e dt.16.11.2011, me këta anëtarë: Hamit Mjeku, Vlora Halimi, Fitim Dedinca, Nazmi Gashi dhe Fatmir Bekteshi.

Pika e 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e OVL-së, të UÇK-së, që në Komisionin për ndarjen e banesave në vend të anëtarit Imer Grajqevci, i cili ka dhënë dorëheqje të jetë Fehmi Mjeku. Ne i kemi 2 Komisione për ndarjen e banesave, njëri është për raste sociale dhe tjetri për ndarjen e banesave të kategorive të dalura nga lufta.

Aziz Bici – Mendoj se duhet me korigjue atë që the se në rast se është ashtu, sepse e the se janë 2 Komisione. Prandaj, ose duhet të jetë përbërje e njejtë, do të thotë me anëtarë të përbashkët për 2 kategoritë e ndara sepse ju thatë se është një Komision për ndarjen e banesave për raste sociale dhe Komisioni tjetër për ndarjen e banesave, të kategorive të dalura nga lufta.

Kryesuesi - Unë thashë se janë 2 Komisione për ndarjen e banesave, njëri për raste sociale dhe tjetri për kategoritë e dalura nga lufta. Komisioni për ndarjen e banesave për kategoritë e dalura nga lufta ka bërë kërkesë që të zëvendësohet njëri anëtar i cili ka dhënë dorëheqje.

Aziz Bici – Ne nuk kemi asnjë arsye pse ky anëtar i Komisionit ka dhënë dorëheqje dhe është dashur para se të votojmë të kemi informacion. Dyshimi është se mund të ketë presione për me u bë një ndarje jo e drejtë.

Mendoj se për një anëtar të Komisionit i cili ka dhënë dorëheqje, ne është dashur të kemi informacion pse ai ka dhënë dorëheqje dhe pse ky tjetri ka pranue për me qenë anëtar i këtij Komisioni. Unë edhe njëherë e shprehu pakënaqësinë time të ndarjes sepse atëherë kur është votue Komisioni, vota ime ka qenë kundër. Mendoj se në një gjendje aq të rëndë sociale të jetë e mundshme me përfitue individë të cilët kanë banesa, kanë kushte më të mira, atëherë në të ardhmen keni me ndërë veten keq, në rast se ky Komision bën ndarje të këqija. Unë me krejtë çka mundem do ta përcjellë punën e këtij Komisioni dhe në të ardhmen në rast se mbeten qytetarët tonë që janë raste sociale të rënda, ose të cilët bëjnë pagesa me qira me familjet e veta, ta dini se unë do të bëjë çmos për me bërë presionin qytetarë për të cilin ju keni me ndërë veten keq, ose do të keni përgjegjësi.

Kryesuesi – Unë nuk e di pse ka dhënë dorëheqje anëtar i Komisionit.

Ibush Mjekiqi – Meqë jam anëtar i Komisionit, unë e them me përgjegjësi të plotë se kurrfarë presioni nuk ka pasë te anëtarët e Komisionit. Unë si Kryetar i Komisionit, i kam dërguar shkresë Shoqatës së veteranëve të luftës, që ta dërgojnë përfaqësuesin e vet në mënyrë që të procedojmë më tutje, për ndarjen e këtyre banesave. Ne i kemi 98 kërkesa prej veteranëve dhe kategorive tjera, të dalura nga lufta dhe asnjë përzgjedhje deri më tani nuk e kemi bërë. Arsyet kanë qenë të shumta dhe një prej tyre ka qenë edhe situata e pandemisë, që na ka kushtëzue mos të punojmë në atë kohë. Gjithsejt i kemi 39 banesa, për kategoritë e dalura nga lufta, ndërsa tjerat do të përzgjedhen. Nëse, nuk mbërrin numri me i shpërnda 39 banesa, të jeni të bidnur se kemi me i shpërnda vetëm 20, sepse këto banesa janë për ato familje të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe nuk kanë qenë përfitues të një programi për rindërtim në kohën e mëhershme. Unë kërkoj që të kompletohet ky Komision dhe të vazhdojmë me përzgjedhjen e atyre banesave. Të gjithë ata që kanë shtëpi, ju siguroj se nuk do të mundem me marrë banesa sepse ne i vizitojmë dhe kemi informacione se kush ka dhe kush nuk ka shtëpi.

Hysni Mjeku – Këtu, u potencua se a ka pasë presion dhe sinqerisht po ju them z.Aziz, edhe në KPF kam bërë pyetje se a ka, por nuk kemi pasë informacion. Mirëpo, e drejta e Shoqatës, ka qenë të zëvendësohet anëtar i cili ka dhënë dorëheqje me anëtarin tjetër, në mënyrë që të përfaqësohet si institucion. Unë besoj se z.Imer Grajqevci, sigurisht se ka punue deri kur ka punue dhe deri ku ka shkue gjendja nuk e di, por besoj se edhe anëtar i tjetër i propozuar do ti nënshtrohet procedurave dhe ne nuk duhet ti lejmë pa përfaqësim. Besoj se anëtar i tashmë i propozuar detalisht e din për të gjithë invalidët e luftës, dëshmorët dhe pjesëtarët e UÇK-së, gjendjen momentale qysh e kanë. Sigurisht se edhe unë e di sepse ata janë pjesë e jona, kështu që neve, nuk mund të na thotë se x personi e ka këtë, apo atë gjendje sepse ne bashkëjetojmë dhe veprojmë me ata. Unë dëshiroj që Komisioni mundësisht të punon, ta shpejton procedurën dhe në një të ardhme ne ta kemi një raport të detalizuar për këtë çështje. Po ashtu, mendoj se Komisioni nuk mund ti anashkaloj ata që vërtetë, kanë më tepër nevojë për banim.

Aziz Bici – Nën kryetar ju thatë se 39, banesa janë për me u nda për kategoritë e dalura nga lufta, por e thatë edhe tjetrën se nëse, janë vetëm 20, ato nuk do të ndahen gabimisht. Atëherë, unë kam pasë të drejtë kur kam thënë se kriteret që përcaktohen janë të gabueshme 50 me 50, kështu është votue Komisioni. Ne mbi bazën e vendimit të Qeverisë, e kemi formue me ato kriteret. Tash, unë dyshoj dhe kam të drejtë të dyshoj pa dallim se ne e njohim njëri tjetrin, ashtu qysh tha edhe z.Hysni Mjekiqi. Unë kam të drejtë me dyshue se këto 18 banesa tjera, po mbeten në kompetencën tuaj si Ekzekutiv, nuk po mbetet në kompetencë të kriterit dhe në kompetencë të së drejtës se kush e meriton atë banesë.

Ibush Mjekiqi – Unë e mora si shembull dhe tash nuk kisha dashtë me u keqkuptue. Për shkak të korrektësisë ky Komision do të mundohet me punue, se ju thatë se do të ndërëni keq dhe për mos me u ndërë keq po qe se janë 20, atëherë 20 banesa dhe unë e mora si pretekst të fjalisë. Prandaj, mos e keqkupto atë.

Aziz Bici - Në rast se janë 39 banesa, për me u nda për këto kategori dhe numri i atyre sipas këtij Komisioni mbërrin deri në 20, atëherë këto tjerat nuk do të ndahen për këto kategori.

Ibush Mjekiqi – Unë e mora vetëm si shembull dhe nuk ka nevojë me u ndjerë keq sepse ai që ka shtëpi nuk do të merrë banesë. Unë nuk ndjehem keq dhe për këtë të sigurova se puna do të shkoj maksimalisht mirë.

Aziz Bici – Unë banesë nuk kam, e ju dikush keni.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, e dëgjova Nënkyetarin që është pjesë e Komisionit, kanë punue dhe kanë qenë 2 takime, z. Grajqevci që do të zëvendësohet me anëtarin tjetër. Uroj që ky Komision ta kryej një pjesë të punës sepse ndryshimi prej Grajqevcit, në Mjekiqin është problem i Shoqatës, që unë pajtohem. Unë i kam 2 pyetje dhe pyetja e parë është se një pjesë me asistencë sociale janë shpallë dhe më është dukë se pjesërisht nuk ka qenë mirë sepse opozita është për me kritikue, për me ndryshue për të mirë. Komisioni për ndarjen e banesave me asistencë sociale, e ka kryer punën bukur shumë dhe një pjesë e banesave janë ndarë dhe pyetja është kur e përfundon punën ky Komision, pasi që punën e ka filluar që një vit. Kjo nga fakti se njerëzit janë largue prej banesave dhe ato banesa kanë mund të shfrytëzohen edhe për këtë vit.

Kryesuesi – Përgjegjen do ta marrësh në pikën “Të ndryshme”.

Enver Gashi – Kryesues, unë kam vërejtje edhe ndaj anëtarëve të Kuvendit, ju lus nëse mendoni se përfaqësoni dikend këtu, përmbajuni rendit të ditës. Ne jemi në pikën e rendit të ditës, për me caktue anëtarin e propozuar nga Shoqata në Komision, e jo të shfrytëzohet kjo foltore kujt çka i teket. Prandaj, kryesues ai që nuk i përmbahet rendit të ditës, ndërpreje.

Aziz Bici – Po shkelet Rregullorja e punës sepse nuk është anëtari i Kuvendit, ai që neve na jepë vërejtje. Këtë, që e thashë unë është dashur me thënë kryesuesi. Anëtari i Kuvendit, ka të drejtë ti propozoj kryesuesit me i dhënë vërejtje në emrin konkret kujt, por nëse kryesuesit nuk po i konvenon me dhënë një sqarim atëherë dikush duhet me dhënë. Ju, z.Enver nuk jeni personi për me i dhënë vërejtje anëtarëve të Kuvendit. Në rast se ju mendoni se e keni fituar atë guxim me bë çka të doni ju në pronat shoqërore, në punësim, këtë harroje. Prandaj, duhet të keni sjellje më të mira sepse kemi për çka i qesim emrat për ato privilegjet që ju i gëzoni kur qytetarët janë duke hequr keq.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.-I-68, të dt.25.04.2019, i Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veqanta, ashtu që në vend të anëtarit Imer Grajqevci, caktohet anëtari Fehmi Mjeku.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në Llazarevë.

Shaip Paloja - Unë dua ta di çështjen e ligjshmërisë sepse vërtetë është absurde. Aty thotë se duhet të jepet prona vetëm aty ku ka energji të ripërtrishme, por KEDS-i, nuk prodhon energji, vetëm shpërnda energji. Pra, edhe nëse është energjia e ripërtrishme dhe shkon te KEDS-i, KEDS-i, vetëm ka me shpërnda atë energji, që do të thotë se edhe ata vetë bëjnë shkelje ligjore. Mendoj se nuk kanë pasë të drejtë që e kanë kthye këtë vendim dhe ky kundërshtim i MPL-së, nuk është i drejtë sepse KEDS-i, vetëm ka me shpërnda energjinë pavarësisht kush ua dërgon, apo me kend e kanë kontratën për shpërndarjen e energjisë. Unë dua të them se vendimi ynë ka qenë plotësisht i ligjshëm, duke u bazuar në kërkesën e MPL-së.

Enver Gashi - Unë dua ta plotësoj pak z.Shaip, sepse nuk e përmendi një element shumë të rëndësishëm lidhur me KEDS-in. Aty e ka një repart KEDS-i, të prodhimit të shtyllave edhe për trafostacione dhe për shtylla, linja 35 kw. Kjo, do të thotë se nuk është vetëm shpërndarës, por edhe prodhues si dhe për shtylla e materiale të ndryshme që i shfrytëzon. Mirëpo, është edhe një repart tjetër prodhues, prandaj nuk di pse MPL-ja, e ka kthye vendimin, apo nuk ka pasë sqarime të mjaftueshme.

Lulzim Sadiku – Unë jam për me shfuqizu vendimin, por më intereson se sa ka qenë sipërfaqja e pronës që i është dhënë.

Kryesuesi – Përgjegjet 1 ha e 70 ari.

Aziz Bici – Kryesues, pse je ti kryesues duhet me punue me Rregullore, do të thotë kur të teket ty me thënë ti je shef i grupit të LVV-së, dhe kur të teket me thënë jo, kjo nuk lejohet me Rregullore. Neve, sot për herë

të parë MPL-ja, nuk po na i kthen vendimet, jo se politikisht që i përgatitë mirë, edhe si Drejtori, dhe si Ekzekutiv. Mirëpo, edhe ju si asambleistë që i takoni partive në pushtet këtu, ju sot është dashur me ardhë më të qartë para neve, me na bindë neve se vërtetë MPL-ja, nuk ka pasë të drejtë me kthye këtë vendim. Nuk mjafton vetëm 1,2, ose 3 anëtarë me thënë jo ka gabue Ministria. Mendoj se jo vetëm ky vendim, por edhe vendimet tjera për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për 99 vjet, kanë me pasë bazë ligjore secila, keni gabue që i keni votue.

Kryesuesi – Sqaron se vendimet e Kuvendit, janë vendime politike dhe kanë me u votue dhe nëse, ne kemi gabue është mirë që dikush na monitoron. Mirëpo, gabimet nuk janë të qëllimshme, prandaj ky është obligimi ligjor që ne duhet me shfuqizue këtë vendim.

Nazmi Gashi – Kryesues, nuk e di pse po humbim kohë sepse ne nuk e kontrollojmë Ministrinë, por Ministria na kontrollon neve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin për shfuqizimin e vendimit nr.-I-126, të dt.29.09.2020, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqi, në zonën kadastrale në Llazarevë.

Kryesuesi – Ju njoftoj se më ka ardhë një kërkesë nga Ismet Mjeku, të cilën sot nuk do ta shqyrtojmë, por mbetet për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Pika e 8 e rendit të ditës


Kryesuesi – Unë e kam një kërkesë nga Drejtoria e administratës, e cila kërkon bashkëpunim tuaj lidhur me Draft Rregulloren për dekorata nderi sepse brenda muajit do të ketë një debat publik dhe ju duhet të merrni pjesë fizikisht, ose përmes emailave me dhënë kontributin tuaj.

Hysni Mjeku – Meqenëse, brenda këtyre 2,3 ditëve do të përfundon projekti për ndriçimin publik në fshatin Graboc i Epërm dhe meqë, vijë nga ajo zonë, jeni të ftuar të gjithë në ditën e përirimit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20'

Bashk.prof.për-punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri